



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 262, Datë 14.10.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDROPOWER”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799 prot., datë 11.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “HYDRPOWER” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “HYDROPOWER” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1747 prot., datë 03.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “HYDROPOWER” sh.pk ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pikës 1.1, gërmat “a”, “b”, dhe “c”; pikës 1.2, gërmat “a” dhe “d” dhe pikës 1.3, germa “b”. Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni si vijon: *Neni 9, Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*
  - **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të përcjellë në ERE me datë të rirfskuar vërtetimin e gjendjes gjyqësore për administratoren e shoqërisë, pasi mban datë më të hershme sesa ajo e parashikuar në nenin 8, pika 3 të rregullores së licencimit. Po ashtu duhet të përcjellë në ERE edhe Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore për vetë shoqërinë “HYDROPOWER” sh.p.k.
  - **gërma “c”**: Referuar kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të përcjellë informacion nëseka personel të mjaftueshëm në funksion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
- *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
  - **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e detyrimeve tatimore me datë të rirfskuar, pasi mban datë më të hershme se ajo e parashikuar në nenin 8, pika 3 të rregullores së licencimit. Po ashtu duke qenë se konstatohet një detyrim i pashlyer ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shoqëria duhet të përcjellë edhe vërtetimin për sigurimet shoqërore e shëndetësore me detyrimin të shlyer.
  - **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të përcjellë në ERE, Planin e Biznesit për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektike.
- *Pika 2.5. Dokumentacioni specifik për licencën e tregtimit të energjise elektrike.* Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE informacion mbi sasitë e energjisë elektrike (në GWh) të parashikuar për t’u tregtuar gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme.
- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HYDRPOWER” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**